




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORMI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 295120

Data. 10.09.20



Prishtinë, 10.09. 2020

Nga: **Arsim Janova**, u.d. Kryesues i Bordit të ZRRE-së
Për: **Z. Serhat Dinç**, Drejtor Menaxhues, KESCO Sh.A
Kopje: **Z. Blerim Kuqi**, Ministër i Ekonomisë dhe Ambientit
Z. Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit të Kosovës
Z. Endrit Shala, Kryesues i Komisionit për zhvillim ekonomik, tregti dhe industri
Z. Alper Erbas, Drejtor Menaxhues, KEDS Sh.A
Znj. Rudina Heroi-Puka, Drejtor për Tarifa dhe Çështje Rregullative, KESCO Sh.A
Z. Avni Alidemaj, Zyrtar i pajtueshmërisë, KEDS Sh.A

Lënda: Shqyrtimi i parametrave hyrës dhe të hyrave të lejuara maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal me energji elektrike (FSHU)

Po ju drejtohem me qëllim të prezantimit të planeve të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) përkitazi me Shqyrtimin i parametrave hyrës dhe të hyrave të lejuara maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal me energji elektrike (FSHU). Gjithashtu gjatë këtij procesi do të bëhet përcaktimi i tarifave të energjisë elektrike, të cilat pritet të hyjnë në fuqi në prill të vitit 2021, ashtu siç është përcaktuar me Rregullat për vendosjen e çmimeve.

ZRRE me ndryshimet ligjore të vitit 2016, ka zhvilluar legjislacionin sekondar në bazë të të cilit ka krijuar kornizë gjithëpërfshirëse rregullative në shërbim të implementimit të Direktivave evropiane dhe ligjeve vendore. Një nga aspektet rregullative esenciale për funksionimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë është siguria e furnizimit për konsumatorët me të drejtë të shërbimit universal. Në këtë kuadër, ZRRE në vitin 2017 ka vendosur Obligim të Shërbimit Publik (OSHP) për furnizim me shërbim universal (FSHU), i cili është vazhduar në vitin 2020 ndaj KESCO.

Duke qenë se ky obligim është vendosur ndaj KESCO, është e domosdoshme që kushtet e tregut të rivlerësohen dhe rrjedhimisht edhe kushtet e furnizimit me shërbim universal. Komponentët kyç të cilët duhet të rivlerësohen në kuadër të FSHU, janë vlerat hyrëse dhe përcaktimi i të hyrave të lejuara maksimale dhe tarifave.

Vlerat hyrëse janë parametra të rëndësishëm për vlerësimin e të hyrave të rregulluara për FSHU, ku gjatë këtij procesi do të rishikohen vlerat hyrëse si më poshtë:

- Jetëgjatësia e asetëve;
- Marzha me pakicë;
- Niveli i lejuar i borxhit të keq;



- Faktori ndarës balancues; si dhe
- Ndonjë parametër tjetër që Rregullatori mund ta konsiderojë të nevojshëm.

Në mënyrë që të bëhet një vlerësim më i saktë i gjendjes aktuale në lidhje me vlerat hyrëse, FSHU duhet të paraqes të dhënat historike dhe analiza të detajuara në lidhje me borxhin e keq, marzhës me pakicë dhe jobalancet e FSHU (me qëllim të vlerësimit të faktorit ndarës), të cilat do të përcaktohen për periudhën e ardhshme 3 vjeçare.

Duke qenë se gjatë këtij procesi do të përcaktohen edhe të hyrat e lejuara maksimale për FSHU, atëherë, ZRRE kërkon nga KESCO (FSHU) që të paraqes të gjitha të dhënat ashtu siç kërkohet me Rregullat në fuqi, duke përfshirë kostot aktuale dhe të lejuara, duke përfshirë kostot operative dhe të mirëmbajtjes si dhe kostot kapitale, për periudhën 2017-2020 si dhe propozimin për tri vitet në vazhdim (2021-2023). KESCO duhet të paraqes kostot e ndara për konsumatorët në kuadër të FSHU si dhe atyre të derregulluar dhe shërbimet e përbashkëta për të dy llojet e konsumatorëve, duke definuar edhe çelësin e alokimit të këtyre kostove. Gjithashtu është e domosdoshme të paraqiten kostot për shërbimet e përbashkëta në mes të KESCO dhe KEDS, në të njëjtin parim.

Rregullatori do të bëjë azhurnimet e rregullta vjetore për FSHU brenda afateve të përcaktuara me rregullat aktuale të vendosjes së çmimeve. Gjatë këtij procesi, do të bëhet një rishikim më i detajuar i tarifës fikse për konsumatorët fundorë me energji elektrike, prandaj KESCO duhet të paraqes një vlerësim të detajuar rreth alokimit të kostove në kuadër të tarifës fikse, duke përfshirë dhe propozimin e ri për tarifën fikse për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

Orari i ndërkohshëm për procesin e përcaktimit të vlerave hyrëse dhe të të hyrave të lejuara maksimale për FSHU do të jetë:

- Procesi i shqyrtimit të vlerave hyrëse do të fillojë së paku 120 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant tarifor;
- Dorëzimi i aplikacioneve dhe propozimeve për vlerat hyrëse dhe të hyrat e lejuara maksimale nga ana e KESCO do të dërgohet në ZRRE, 28 ditë kalendarike, prej ditës së pranimit të formularëve nga ana e ZRRE-së;
- ZRRE do të shqyrtojë dhe të publikojë propozimet preliminare brenda 28 ditëve nga pranimi i aplikacioneve nga KESCO.
- Diskutimi publik do të zgjasë 14 ditë kalendarike. Brenda kësaj periudhe KESCO dhe të gjitha palët e interesit mund të paraqesin komentet e tyre;
- ZRRE, pas vlerësimit të komenteve do të paraqes propozimin përfundimtar për shqyrtim nga Bordi i ZRRE-së.
- Aplikimi i KESCO për tarifën me pakicë për konsumatorët fundorë, do të bëhet sipas orarit të përcaktuar në Rregullën për Çmimet e FSHU.

Ky orar është i ndërkohshëm dhe mund të pësojë ndryshime të vogla, varësisht prej rrethanave.



Për shkak të transparencës, ZRRE do të publikojë në tërësi dokumentet të cilat ndërlidhen me këtë proces. Prandaj, të licencuarit duhet të identifikojnë ndonjë pjesë të cilën e konsiderojnë si konfidenciale.

Për çdo paqartësi apo informacion shtesë, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni.

Me respekt,

Arsim Janova

U.d. Kryesues i Bordit të ZRRE-së

